

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË "Europa Commercial" Sh.p.k

Sot, me date 27/12/2024,

Z. Ermal Tafaj, shtetas Shqiptar, lindur më 15/11/1979, në –Tirane, Shqiperi, mbajtëse i kartes ID me nr 037588222, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Znj. Ervina Serani, shtetase Shqiptare, lindur më 02/11/1988, ne Thumane, Shqiperi, mbajtëse e kartes ID me nr –034309637–, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "–Europa Commercial –. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "Europa Commercial " Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: : Njësia Bashkiake nr.7, Rruga "Ndre Mjeda", ndërtesa nr.31, hyrja nr.2, Tiranë, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.



NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj: Kryerjen e shërbimeve postare të llojeve të ndryshme, përfshirë dërgesat postare përmes tokës, detit, ajrit, si dhe çdo mënyrë tjetër teknologjike, brenda Shqipërisë dhe jashtë territorit të saj. Tranzitimin e mallrave nga të gjitha pikat kufitare të Shqipërisë. Ushtrimin e veprimtarisë së transportit ajror, detar dhe tokësor për udhëtarët dhe mallrat brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Ushtrimin e veprimtarisë si agjenci doganore, ofrimin e shërbimeve doganore dhe magazinimin doganor. Importin dhe eksportin e të gjitha llojeve të mallrave dhe tregtimin e tyre me shumicë dhe pakicë. Kryerjen e veprimtarisë postare dhe të shërbimeve të korrierëve, si dhe magazinimin apo ruajtjen e mallrave, produkteve apo pajisjeve. Importimin dhe eksportimin, me shumicë dhe pakicë, të çdo shërbimi, malli, pajisjeje/makinerie, apo çdo gjëje tjetër që mund të jetë e nevojshme ose e rëndësishme për realizimin e aktiviteteve të ligjshme të shoqërisë. Shërbimin si përfaqësuese e shitjes dhe marketingut, si dhe agjent shitjesh për shoqëri vendase dhe të huaja. Transportin dhe shpërndarjen e mallrave në adresa, përfshirë shpërndarjen dhe distribucionin online. Kryerjen e çdo aktiviteti tjetër ekonomik që është i nevojshëm dhe i dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë dhe që nuk është në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 100.000 leke dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Ermal Tafaj**, zoteron 1 kuotë, me 60% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 60,000 Leke dhe 60,000 Leke të kapitalit themeltar..
- **Znj. –Ervina Serani—**, zoteron 1 kuotë, me 40% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë —40,000— Leke dhe —40,000— Leke të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.



NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm i shoqërisë është **Znj. Ervina Serani**, shtetase Shqiptare, lindur më -02/11/1988-, në Thumane, Shqiperi, mbajtëse i kartes I me nr.-034309637-, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8


DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Znj. -Ervina Serani-**, shtetase Shqiptare, lindur më -02/11/1988-, në —Thumane—, Shqiperi, mbajtëse e kartes ID me nr.-034309637—, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Z.Ermal Tafaj



Znj.Ervina Serani

